



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi

Mbledhja nr. 22. 2009

Prishtinë, më 22 qershor 2009, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi

**Morën pjesë:** Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli dhe Adem Hajdaraj.

**Munguan:** Branislav Grbiq, Dzezair Murati, Kolë Berisha dhe Selvije Halimi.

**Të pranishëm:** Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti - KDI, Reshit Gashi – NDI, Petrit Hysaj - OSBE, Almir Hyseni – EULEX, Gjyze Milla Loyla University USA dhe Visar Krasniqi - Kuvendi i Kosovës.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 15 qershorit 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
4. Shqyrtimi i propozimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të shërbimit civil;
5. Shqyrtimi i propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e

anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit;  
6. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** - Pasi i përshëndeti të pranishmit i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit dhe propozoi të fillohet me pikën e pestë të rendit të ditës. I pranishëm ishte drejtori i Institutit Gjyqësor, Lavdim Krasniqi, të cilin e falënderoi posaçërisht. Në vazhdim shtoi se do të ishte e rëndësishme prezenca e ndonjërit nga përfaqësuesit e Komisionit për Integritet Evropian, lidhur me rekomandimet e bëra për Projektligjin për konfliktin e interesit publik.

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.*

## **2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së 15 qershorit 2009**

*Miratimi i procesverbalit shtyhet për mbledhjen e radhës.*

## **5. Shqyrtimi i propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit.**

**Kryetari** - I njoftoi anëtarët për propozimet e Institutit Gjyqësor, më ç' rast i njoftoi për mungesën e propozimeve të dy kandidatëve nga radhët e minoriteteve, ashtu siç e parasheh Ligji. Po ashtu si shqetësim është ngritur edhe çështja e moshës së këtyre kandidatëve, edhe pse një gjë të tillë Ligji nuk e ndalon. Prandaj ftoi Lavdim Krasniqin ta merrte fjalën.

**Lavdim Krasniqi** - E falënderoi Komisionin për ftesën dhe e njoftoi për përbërjen e Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Theksoi se 6 kandidatëve u ka skaduar mandati. Disa nga institucionet, në propozimet e tyre, kanë përfshirë të njëjtit kandidatë edhe për një mandat. Ndërsa sa i përket vonesës lidhur me propozimet e bëra, ceku si shkak që disa nga këta kandidatë janë gjyqtarë, prokurorë dhe deri në përfundimin e procesit të riemërimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve nuk kanë mundur të propozohen. Shprehu gatishmërinë për harmonizimin e veprimeve me Komisionin për mungesën e dy kandidatëve nga radhët e minoriteteve.

**Ibrahim Makolli** – Duke u ndërlidhur me parafolësin u pajtua sa i përket funksionimit të Institutit Gjyqësor, kurse për bordin tha se nuk funksionon. Prandaj propozimet për kandidatët e mundshëm është dashur të bëheshin me kohë, jo vetëm pas skadimit të mandatit.

**Adem Hajdaraj** - Shprehu shqetësimin për mungesën e propozimeve nga radhët e minoriteteve, që sipas tij e bllokojnë punën.

**Bajram Kosumi** – Në diskutimin e tij ngriti çështjen e votimit të këtyre kandidatëve, do të thotë “de fakto” përkrahje e modelit të punës së këtij instituti, edhe pse nuk kemi qenë të kënaqur me Raportin e punës së tij. Prandaj nëse dëshirojmë cilësi, duhet të kthehen mbrapa këto propozime dhe të kërkojmë të tjera.

**Armend Zemaj** – Ripërsëriti qëndrimin e tij se është kundër këtyre propozimeve. Si arsye ceku moshën dhe punën e këtij instituti. Duke shtuar se si emra janë shumë të respektuar, por mosha dhe puna e këtij instituti nuk paraqesin garanci për reforma.

**Adem Salihaj** – Vuri në pah se propozimet e bëra për moshën nuk korrespondojnë me çështjen moderne të reformimit të gjyqësorit. Është e drejtë e këtyre institucioneve, që i kanë bërë këto propozime, por nuk mendoj se janë më të mirët.

*Pas një debati që u zhvillua lidhur me këtë pikë Komisioni nxori këtë:*

## **P e r f u n d i m**

- I. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi për herë të dytë i shqyrtoi propozimet për Këshillin Drejtues të IGJK-së dhe konstatoi se institucionet nuk i kanë propozuar dy anëtarë nga radhët e minoriteteve, të cilët i obligon Ligji.
- II. Komisioni për propozimet ka shqetësime për moshën e tyre dhe sugjeron që këto shqetësime ky institut t'i ketë parasysh.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik**

**Kryetari** - Konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për një nga mbledhjet e radhës të Komisionit.

### **4. Shqyrtimi i propozimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të shërbimit civil**

**Kryetari** – E informoi Komisionin se punëtorët në gjykata konsiderohen shërbyes civilë, që nënkupton se administrata e Gjyqësorit nuk e përbën shtyllën e tretë të pushtetit, por gjyqtarët dhe prokurorët. Prandaj kjo duhet kuptuar drejt.

**Ibrahim Makolli** – Propozoi që shqyrtimi i propozimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të shërbimit civil të shtyhet, sepse ky ligj është tërhequr. Prandaj nuk mund të diskutojmë për një dokument kur nuk mund ta dimë përmbajtjen e tij.

## **6.Të ndryshme**

### **Shqyrtimi i Projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar**

Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të Projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar dhe vlerësoi se ligji ka bazë juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

### **Përgatitja e Raportit me rekomandime për Ligjin penal për të mitur**

**Kryetari-** Për Ligjin penal për të mitur i njoftoi anëtarët dhe shtoi se e kemi monitoruar këtë ligj në institucionet relevante. Raporti me rekomandimet duhet të përfundojë, në mënyrë që të jetë i gatshëm për mbledhjen e radhës.

### **Shqyrtimi i Projektligjit për hetim parlamentar**

**Kryetari,** - Njoftoi se dëgjimi publik për Projektligjin për hetim parlamentar, që do të mbahet më 29. 06. 2009, në orën 10, do të kërkojë nga administrata t'i ftojë institucionet relevante: EULEX-in, OSBE- në, përfaqësuesin civil ndërkombëtar, OAK, USAID-in dhe institucionet e tjera, në mënyrë që t'i presim sugjerimet dhe vërejtjet e tyre që të inkorporohen në Ligj.

### **Shqyrtimi i kërkesës së Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisjen lokale.**

*Komisioni pasi debatoi lidhur me këtë pikë nxori këtë*

## **P e r f u n d i m**

Komisioni, pasi e shqyrtoi kërkesën e Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr .03-040 për vetëqeverisjen lokale, konstatoi se nisma e tillë ka bazë ligjore në nenin 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërsa procedura për propozimin e amendamenteve dhe mënyra e procedimit të Projektligjit në Kuvend, nuk janë rregulluar me Ligj.

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni